REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Zbatimi i Rekomandimeve, të lëna gjatë vitit 2023 (pjesa II)

Shkurt 2025

+355 4 2247294 www.klsh.org.al

PËRMBAJTJA

1 HYRJE 5

2 PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE 7

3 KUFIZIME 8

4 REZULTATET SIPAS SUBJEKTEVE 9

5 PËRMBAJTJA E TABELAVE 25

"SAI-et janë kujdestarët e besimit publik. Ata e fitojnë atë besim përmes auditimeve rigoroze, por arrijnë ta mbajnë atë vetëm përmes ndjekjes efektive "

XXIV INCOSAI

POPULLATA E AUDITIMIT

Gjithsej 97 auditime

- 37 Auditime përputhshmërie
- 1 Auditim financiar
- 45 Auditime të kombinuara
- 8 Auditime IT
- 5 Auditime performance
- 1 Auditim tematik

Gjithsej 3937 rekomandime

- 2372 Masa organizative
- 25 Përmirësime ligjore
- 631 Efekte financiare (në numër)
- 863 Masa disiplinore
- 46 Masa administrative

Gjatë procesit të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, puna e KLSH mbështetet në:

"Kompetencat e Institucioneve Supreme të Auditimit" parashikuar në INTOSAI-P 1 "Deklarata e Limës", ku parashikohet se subjekti i audituar duhet të komentojë mbi rezultatet e auditimit brenda një periudhe kohe të vendosur me ligj ose nga SAI, si dhe të paraqesë masat e marra për zbatimin e rekomandimeve;

Deklaratën e Meksikos, konkretisht në INTOSAI-P 10 "Mbi pavarësinë e SAI-eve"; INTOSAI-P 11 "Ekzistenca e mekanizmave të ndjekjes së rekomandimeve të SAI-t"; INTOSAI-P 12 "Vlerat dhe përfitimet e SAI-eve - të bësh diferencën në jetën e qytetarëve";

Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", në nenet 15 dhe 30 të të cilit parashikohet periudha e kthimit të përgjigjies si dhe e drejta e KLSH për t'iu drejtuar organeve më të larta të kompetencës në rast të moszbatimit të rekomandimeve të lëna; si dhe në

Manualin "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistri elektronik institucional" miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 67, datë 13.06.2020

OBJEKTIVAT

Performanca institucionale nuk mund të arrihet pa konsolidimin e një sistemi efektiv të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe kjo është rruga e vetme e përmbushjes së qëllimeve strategjike të misionit dhe vizionit institucional, si dhe pritshmërive të Kuvendit, publikut dhe gjithë palëve të interesit. Sa më sipër gjithashtu në linjë me objektivin strategjik nr. 2 të KLSH-së , nëpërmjet të cilit KLSH synon të rrisë impaktin e punës audituese dhe të kontribuojë në mirëqeverisje, përgjegjshmëri, llogaridhënie dhe transparencë të fondeve publike, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve të qarta dhe të orientuara drejt veprimeve konkrete

ROLET

Kërkesat e Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP), përcaktojnë qartë rolet e përgjegjësitë e subjekteve të audituara dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-eve), sipas të cilave është thelbësore që përgjegjësia për implementimin e rekomandimeve në kohë dhe me efektivitet është e subjekteve të audituara; por nga ana tjetër është përgjegjësi e SAI-ve ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, pra verifikimi nëse veprimet e ndërmarra i shërbejnë rezultatve të pritshme.

PËRFITIMET

Procesi për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe inicimi e zbatimi i masave korrigjuese nga subjektet e audituara, jep një informacion të detajuar mbi vlerën e shtuar që sjell puna e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe njëherazi jep garanci për profesionalizmin, pavarësinë dhe objektivitetin e institucionit.

Konsolidimi i një mekanizmi efektiv të verifikimit sistematik dhe raportimit të zbatimit të rekomandimeve, bazuar në metodologji dhe procedura të standardizuara, të qarta dhe të mirë detajuara, i lejon jo vetëm Kontrollit të Lartë të Shtetit por dhe palëve të treta Kuvendit, Qeverisë etj, të sigurojnë në vijimësi, një informacion të plotë, lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e subjekteve të audituara për hartimin e dokumenteve strategjike në nivel institucional dhe kombëtar apo për iniciativa për ndryshime ligjore, administrative dhe organizative. Për këtë qëllim, KLSH popullon në mënyrë periodike, me të dhëna, Platformën Ndërinstitucionale të Kuvendit.

Skemat dhe qasja e përdorur për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, synojnë të gjenerojnë indikatorë të konsoliduar institucional, sa i takon pranueshmërisë dhe zbatueshmërisë së rekomandimeve, duke mundësuar në këtë mënyrë rritjen e mbikëqyrjes parlamentare nga ana e Kuvendit ndaj ekzekutivit, me efekt rritjen e përgjegjshmërisë së menaxhimit të fondeve publike.

Nga verifikimi mbi respektimin e afateve ligjore për kthimin e përgjigjies 20 ditore, rezultoi se:

- në zbatim të nenit 15, pika j, e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", 74 subjekte kanë kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 20 ditor, mbi statusin e rekomandimeve të lëna;
- dhe 26 subjekte nuk kanë kthyer përgjigje, në kundërshtim me nenin 30, pika 2, e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".



Burimi: Shkresat dërguar nga subjektet e audituara

Nga verifikimi mbi respektimin e afateve ligjore për kthimin e përgjigjies 6 mujore, rezultoi se:

- në zbatim të nenit 30, pika 2, e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", 40 subjekte kanë kthyer përgjigje brenda 6 muajve, mbi statusin e rekomandimeve të lëna;
- 55 subjekte nuk kanë kthyer përgjigje, në kundërshtim me nenin 30, pika 2, e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; dhe
- për 5 subjekte nuk ishte përmbushur ende afati për të kthyer përgjigje, në momentin e kryerjes së verifikimit.



Burimi: Shkresat dërguar nga subjektet

Referuar përgjigjeve sa më sipër, dhe më pas edhe verifikimit të tyre në terren, rezultoi se nga 3937 rekomandime të lëna gjithsej, **3882 rekomandime janë pranuar⁎, ose rreth 99%** e total rekomandimeve; dhe nuk janë pranuar 55 rekomandime, ose rreth 1% e tyre.



Burimi: Shkresat e subjekteve të audituara

Në përfundim, 2705⁎⁎ masa ose **rreth 70%** e masave rezultuan të zbatuara plotësisht, pjesërisht dhe në proces zbatimi. Konkretisht, nga total 3882 masa të pranuara, 1261⁎⁎ masa rezultuan të jenë zbatuar plotësisht (ose rreth 33% e total masave të pranuara), 578 masa zbatuar pjesërisht (ose rreth 15% e total masave të pranuara), 866 në proces zbatimi (ose rreth 22 % e total masave të pranuara); ndërsa 1177⁎⁎⁎ masa janë ende pa zbatuar (ose rreth 30% e total masave të pranuara).

⁎ Konsiderohen me status "pranuar" : (i) rekomandimet për ato subjekte që nuk kanë sjellë përgjigje brenda 20 ditëve sipas nenit 15, shkronja j të ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; (ii) rekomandimet për të cilat subjekti i audituar edhe pse ka sjellë shkresën e kthimit e përgjigjes 20 ditore, nuk është shprehur mbi statusin e pranueshmërisë.; si dhe (iii) janë përfshirë në këtë rast edhe 19 rekomandime me status "pranuar pjesërisht".

⁎⁎ Janë përfshirë tek statusi "zbatuar" edhe 61 rekomandime, që nuk janë më relevante.

⁎⁎⁎ Janë përfshirë tek statusi "pa zbatuar" edhe 10 rekomandime, për të cilat subjektet nuk janë shprehur

2. PËRMBLEDHJA E REZULTATEVE

Nga verifikimet e kryera gjatë vitit 2024, për 97 auditime të kryera nga KLSH gjatë vitit 2023, lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, rezultoi se janë dhënë gjithsej 3937 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht dhe pjesërisht 3882* masa, ose 99% (që përfshijnë 25 përmirësime ligjore, 2358 masa organizative, 184 masa shpërblim dëmi, 420 masa për shpenzime pa eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet, 46 masa administrative dhe 863 masa disiplinore); dhe nuk janë pranuar 55 masa, ose rreth 1%.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga 3882 masat e pranuara, janë zbatuar plotësisht 1261* masa ose 33%, pjesërisht 578 masa, ose 15%; janë në proces zbatimi 866 ose 22%; ndërsa 1177 masa, ose rreth 30% nuk janë zbatuar, të cilat të grupuara sipas llojit paraqiten si vijon:

A. Rekomanduar gjithsej 25 "Masa për përmirësime ligjore", të cilat janë pranuar në masën 100%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuara janë zbatuar plotësisht 9 masa ose 38%, pjesërisht 4 masa ose 17%, në proces zbatimi 7 masa ose 29% dhe pa zbatuar 5 rekomandime, ose 17%.

B. Rekomanduar gjithsej 2372 "Masa organizative", nga të cilat janë pranuar 2358 masa ose në masën 99%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuara janë zbatuar plotësisht 742 masa ose 32%, zbatuar pjesërisht 338 masa ose 14%, janë në proces zbatimi 584 ose 25%, nuk janë zbatuar 694 ose 29% e tyre.

D. Rekomanduar 195 "Masa për shpërblim dëmi (në numër)" ,nga të cilat janë pranuar 184 ose 94%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuara janë zbatuar plotësisht 53 masa ose 30%, pjesërisht 47 masa ose 24%, janë në proces zbatimi 28 masa ose 15% dhe nuk janë zbatuar 56 masa ose 31%.

C. Rekomanduar 436 "Masa për eleminimin e efekteve negative (në numër) nga të cilat janë pranuar 420 masa ose 96% dhe nuk janë pranuar 16 masa ose 4%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuara janë zbatuar plotësisht 62 masa ose 15%, pjesërisht 98 masa ose 23%, janë në proces zbatimi 129 masa ose 31% dhe nuk janë zbatuar 131 masa ose 31%.

E. Rekomanduar 863 "Masa disiplinore", nga të cilat janë pranuar 849 masa ose 98%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuara janë zbatuar plotësisht 389 masa ose 46%, pjesërisht 63 masa ose 7%, janë në proces zbatimi 118 masa ose 14% , nuk janë zbatuar 279 masa ose 33%.

F. Rekomanduar 46 "Masa administrative", të cilat janë pranuar në masën 100%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuara janë zbatuar plotësisht 6 masa ose 17%, pjesërisht 28 masa ose 61%, dhe nuk janë zbatuar 12 masa ose 26%.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin *"pa zbatuar"* dhe *"zbatuar pjesërisht"*, nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status *"në proces zbatimi"* inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

** Konsiderohen me status "pranuar" edhe ato rekomandime për të cilat subjekti i audituar edhe pse ka sjellë shkresën e kthimit e përgjigjes 20 ditore, nuk është shprehur mbi statusin e pranueshmërisë.; si dhe rekomandimet për të cilat subjektet në kundërshtim me nenin 15, shkronja j të ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nuk kanë kthyer përgjigje mbi statusin e rekomandimit*

***Këtu janë përfshirë dhe 61 rekomandimet që nuk janë më relevante*

3. KUFIZIME

Pavarësisht verifikimit të zbatimit të rekomandimeve dhe rezultateve të konstatuara nga KLSH dhe të paraqitura në këtë raport, procesi në vetvete mbart disa kufizime, të cilat mund të ndikojnë në treguesit "pa zbatuar", "në proces zbatimi" dhe "pjesërisht", dhe që duhen mbajtur në konsideratë në vijim.

- Ndryshe nga auditimet tradicionale financiare ose të pajtueshmërisë, auditimet e performancës fokusohen në vlerësimin e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit të operacioneve ose programeve të një ose më shume insitucioneve publike, pjesë e të njëjtit sistem/proces. Si rezultat, rekomandimet që rrjedhin nga auditimet e performancës shpesh kërkojnë ndryshime të shumëanshme që përfshijnë sisteme, procese ose politika komplekse. Këto auditime shkojnë përtej identifikimit të thjeshtë të çështjeve; ato analizojnë shkaqet kryesore, propozojnë zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe shpesh kërkojnë ristrukturim ose riinxhinierim të rëndësishëm për t'u zbatuar në mënyrë efektive.
  Rrjedhimisht, zbatimi i rekomandimeve nga auditimet e performancës kërkon një proces më të ndërlikuar që kërkon kohë dhe që përfshin bashkëpunimin e palëve të interesuara, shpërndarjen e burimeve, rregullimet e politikave dhe ndonjëherë ndryshime legjislative ose organizative.
  Kjo natyrë e ndërlikuar e adresimit të përmirësimeve sistemike kontribuon në një afat kohor më të zgjatur të zbatimit të rekomandimeve në auditimet e performancës, në krahasim me llojet e tjera të auditimit.

- Auditimet IT, gjithashtu kërkojnë më shumë kohë për tu zbatuar në krahasim me auditimet tradicionale financiare ose të pajtueshmërisë, për shkak të kompleksitetit të sistemeve. Zbatimi i këtyre rekomandimeve shpesh kërkon burime të dedikuara, duke përfshirë personelin e kualifikuar dhe financimin. Departamentet e TI-së mund të kenë nevojë të ripërcaktojnë detyrat dhe të ndajnë burime shtesë për të adresuar rekomandimet në mënyrë efektive. Njëkohësisht zbatimi i ndryshimeve në sistemet e TI-së mund të mbart risqe të tilla si: ndërprerja, humbja e të dhënave ose cënueshmëria e sigurisë, kështu që ekipet e TI duhet të vlerësojnë këto rreziqe dhe të planifikojnë në përputhje me rrethanat për të minimizuar ndikimet e mundshme negative.

- Gjithashtu mund të ketë edhe rekomandime, të cilat me kalimin e kohës, mund të rezultojnë jo relevante për shkak të ndryshimeve të diktuara së jashtmi, dhe për pasojë nuk mund të zbatohen më.

4. REZULTATET SIPAS SUBJEKTEVE

1. Gjykata e Lartë

Nga auditimi i ushtruar në Gjykatën e Lartë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2020-30.09.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën 554/8, datë 21.02.2023, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë,8 rekomandime masa organizative, të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht.

2. Autoritetin e Mediave Audiovizive

Nga auditimi i ushtruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2019-30.06.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën 896/9 datë18.05.2023, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti po vijon përgatitjen e planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari, pasi ndodhet brenda afatit 6 mujor, sikundër specifikohet në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30, pika 2 e tij..

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a)Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 2 masa për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 35 rekomandime masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 24 zbatuar, 10 në proces zbatimi dhe 1 pa zbatuar.

c) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 rekomandim "Masë Administrative", i cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit: 1 rekomandim është zbatuar.

d) Për përmirësimin e gjendjes është 1 rekomandim shpërblim dëmi, i cili është pranuar dhe zbatuar plotësisht.

e) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 6 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike nga ku 6 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht dhe rezultuan në proces zbatimi.

f) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 rekomandim "Masë Disiplinore", i cili është pranuar plotësisht dhe është zbatuar.

e) Për marrjen e masave administrative nëpërmjet aplikimit të sanksioneve ligjore në përputhje me kuadrin ligjor ne fuqi, është lënë 1 rekomandim, i cili është zbatuar plotësisht.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

3. Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiare" për periudhën 01.01.2017 deri më 30.06.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën 792/9 Prot., datë 18.01.2023, rezultoi se:

- subjekti ka dërguar planin e veprimit me shkresën me nr. prot., 1428 datë 27.03.2023 me lëndë "Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit "Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiare" nga KLSH", jashtë afatit ligjor 20 ditë, të përcaktuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja "j".
- subjekti, në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 rekomandime "Për përmirësime ligjore", të cilat janë pranuar plotësisht 2, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 Zbatuar, 1 në proces zbatimi.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 13 rekomandime për masa organizative nga, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 4 zbatuar, 3 në proces zbatimi dhe 6 pa zbatuar.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

4. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Nga auditimi i ushtruar në subjektin Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët e, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2021-31.08.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën 792/9 Prot., datë 18.01.2023, rezultoi se:

- subjekti ka dërguar planin e veprimit me shkresën me nr. 4978/10 prot., datë 14.02.2023 me lëndë "Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit "Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiare" nga KLSH", jashtë afatit ligjor 20 ditë, të përcaktuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja "j".
- subjekti, në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 9 rekomandime organizative, të cilat janë pranuar plotësisht 9 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 8 zbatuar, 1 në proces zbatimi.

b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë për menaxhimin me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore, nga ku 1 rekomandim është pranuar plotësisht dhe rezultoi në proces zbatimi.

c) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë disiplinore e cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë pa zbatuar.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

5. Agjencia Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiare" për periudhën 01.01.2017 - 31.12.2021, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr.730/16 datë 03.05.2023, rezultoi se:

- Subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.1604/2 datë 05.06.2023, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja "j".
- Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, AKSHI është brenda afatit brenda afatit 6 mujor të njoftimit të KLSH-së lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, sipas kërkesave të me ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 24 rekomandim "masa organizative", të cilat janë pranuar 24 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit: 16 janë zbatuar, 8 janë në proces zbatimi.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 rekomandime "masa shpërblim dëmi", cilat janë pranuar 3 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit: 1 zbatuar pjesërisht dhe 2 janë të pazbatuara.

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit: 2 janë zbatuar dhe 2 janë në proces zbatimi.

d) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë Disiplinore e cila është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit "në proces zbatimi".

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

6.Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2020 - 31.12.202, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën 1176/8 Prot, datë 30.06.2023, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik është brenda afatit brenda afatit 6 mujor të njoftimit të KLSH-së, lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, sipas kërkesave të me ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 24 "Masa organizative" të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 11 zbatuar plotësisht dhe 13 në proces zbatimi.

b) Për marrjen e masave për shpërblim dëmi janë lënë 2 rekomandime të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotesisht.

c) Për marrjen e masave për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike janë lënë 7 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 6 masa janë zbatuar plotësisht dhe 1 masë në proces zbatimi.

d) Për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, janë lënë 22 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 19 masa në proces zbatimi, dhe 3 masa janë lënë për punonjës tashmë të larguar nga puna.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

7. Ministria e Infrastukturës dhe Energjisë

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Infrastukturës dhe Energjisë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2020 deri në 31.12.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën Nr.808/62 Prot. datë 19.09.2022 rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 34 rekomandime "masa organizative", dhe 1 "përmirësim ligjor" të cilat janë pranuar 35 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 4 "në proces", 4 "pa zbatuar", 5 "zbatuar pjesërisht", 21 "zbatuar plotësisht" dhe 1 përmirësim ligjor, "zbatuar plotësisht"

b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 rekomandim "masa shpërblim dëmi", pranuar 1 dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 "zbatuar plotësisht".

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 "pa zbatuar" dhe 1 "zbatuar plotësisht"

d) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë disiplinore, e cila është pranuar plotësisht dhe ka rezultuar "jo relevante".

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

8. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Nga auditimi i ushtruar në, Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2020 deri në datën 30.09.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën Nr.894/9 Prot. datë 15.11.2023 rezultoi se:

-subjekti nuk ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

-subjekti ka raportuar për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 47 "Masa organizative" dhe 4 "Përmirësime ligjore" të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë si më poshtë: 14 "në proces" , 17 "pa zbatuar", 7 "zbatuar pjesërisht", 9 "zbatuar plotësisht" dhe 4 përmirësime ligjore me statusin, "2 pa zbatuar", "1 në proces" dhe "1 zbatuar plotësisht."

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 rekomandime"masa shpërblim dëmi" pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 "zbatuar pjesërisht "dhe 1 "pa zbatuar"

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 12 rekomandime për eliminimin e efekteve negative pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 11 në "proces zbatimi" dhe 1 "pa zbatuar."

Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 14 masa disiplinore të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë rezultuar 2 për punonjës të larguar me status jo relevant dhe 12 pa zbatuar.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

9. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale

Nga auditimi i ushtruar në, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë" për periudhën 01.04.2021 deri më datën 31.12.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën Nr.1178/11 Prot, datë 31.07.2023 rezultoi se:

-subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.

-subjekti nuk ka raportuar për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 36 "Masa organizative" nga të cilat janë pranuar plotësisht 35 dhe kanë statusin e ecurisë si më poshtë: 23 në proces, 10 pa zbatuar, 1 zbatuar pjesërisht, 1 zbatuar plotësisht dhe 1 pa pranuar dhe pa zbatuar.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 rekomandime"masa shpërblim dëmi" pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 "në proces"

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 rekomandime për eliminimin e efekteve negative pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 " zbatuar pjesërisht"

d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 14 masa disiplinore të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë rezultuar 'zbatuar plotësisht'

e) Për fillimin e procedurës për dhënien e masës administratitve në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, janë lënë 2 rekomandime, të cilët janë pranuar dhe zbatuar plotësisht..

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

10. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë" për periudhën 01.04.2021 deri në 31.12.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën 1175/28 Prot., datë 01.08.2023 rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 31 rekomandime "masa organizative të cilat janë pranuar 30 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 8 "në proces", 4 "pa zbatuar", 6 "zbatuar pjesërsisht", 12 "zbatuar plotësisht" dhe 1 pa pranuar pa zbatuar.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 rekomandime "masa shpërblim dëmi", pranuar 3 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 "në proces" dhe 2 "zbatuar plotësisht".

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 "në proces" dhe 2 "zbatuar pjesërisht"

d) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë disiplinore, e cila është pranuar plotësisht dhe ka rezultuar 'zbatuar pjesërisht'.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

11. Ministria e Drejtësisë

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Drejtë sisë , për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022 , trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën Nr. 249/14 Prot, datë 11.09.2023 rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 20 rekomandime "masa organizative të cilat janë pranuar 20 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 8 "në proces", 4 "pa zbatuar" dhe 8 "zbatuar plotësisht".

b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 rekomandim "masa shpërblim dëmi", pranuar 1 dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 "në proces".

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

12. Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Nga auditimi i ushtruar në Qendrën Spitalore Universitare "Në në Tereza", për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë" për periudhën 01.04.2021 deri më datën 31.12.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën Nr. 1177/29 Prot, datë 22.12.2023 rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në pë rputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 85 rekomandime "masa organizative", të cilat janë pranuar 85 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 22 "në proces", 37 "pa zbatuar", 8 "zbatuar pjesërisht" dhe 18 "zbatuar plotësisht"

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 8 rekomandime "masa shpërblim dëmi", pranuar 8 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 "në proces", 3 "pa zbatuar" dhe 4 "zbatuar pjesërisht"

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 3 "pa zbatuar"

d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 52 masa disiplinore, të cilat janë pranuar plotësisht dhe 'zbatuar plotësisht'

e) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 masa administrative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe 'zbatuar plotësisht'

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

13. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit social shtetëror / Shtëpia e të moshuarve (Tiranë-Shkodër)

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit social shtetëror; Shtëpia e të moshuarve (Tiranë-Shkodër), për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën nr. 438/12 Prot., datë 29.12.2023 rezultoi se:

- subjekti nuk ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 25 rekomandime "masa organizative", dhe 4 "përmirësime ligjore" të cilat janë pranuar 29 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 16 në proces, 2 'pa zbatuar', 7 'zbatuar plotësisht' dhe 4 'përmirësime ligjore' si vijon, 3 'në proces' dhe 1 'pa zbatuar'.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 "në proces" dhe 1 "pa zbatuar"

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 29 masë disiplinore, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë rezultuar 29 "në proces" dhe 1 masë "jo relevante"

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

14. Rrjeti Akademik Shqiptar - RASH

Nga auditimi i ushtruar në RASH, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit", për periudhën01.01.2020-30.12.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën 74/6, datë 13.06.2023, rezultoi se:

- subjekti nuk ka miratuar dhe dërguar në KLSH planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 10 "Masa organizative" të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon,: 8 zbatuar plotësisht, 1 në proces zbatimi dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

15. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial - ISHTI

Nga auditimi i ushtruar në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial - ISHTI, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit" për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën 1189/6 prot, datë 09.05.2023, rezultoi se:

- subjekti nuk ka miratuar dhe dërguar në KLSH planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 14 "Masa organizative" të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 3 zbatuar plotësisht, 10 në proces zbatimi dhe 1 masë nuk është zbatuar.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

16. Instituti i Sigurimeve Shoqërore - ISSH

Nga auditimi i ushtruar në ISSH, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit" për periudhën 01.01.2021-31.12.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën 1188/5, date 18.05.2023, rezultoi se:

- subjekti ka miratuar dhe dërguar në KLSH planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 17 "Masa organizative" të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 5 zbatuar plotësisht, 7 në proces zbatimi, 3 janë zbatuar pjesërisht dhe 2 masa nuk janë zbatuar.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

17. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve tëTransportit Rrugor

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin IT" për periudhën 01.01.2021 deri në 31.07.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën Nr. 599/6 Prot, datë 10.01.2024 rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 28 rekomandime "masa organizative", të cilat janë pranuar 28 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 10 'zbatuar plotësisht', 15 'në proces' dhe 3 'pa zbatuar'.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

18. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin IT' për periudhën 01.01.2021-30.04.2023, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën Nr. 359/8 prot, datë 15.09.2023 rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
- subjekti, në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 30.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 16 rekomandime "masa organizative" dhe 1 "përmirësim ligjor", të cilat janë pranuar 17 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 2 'në proces', 2 'pa zbatuar', 1 'zbatuar pjesërisht', 10 'zbatuar plotësisht' dhe 1 përmirësim ligjor, 'zbatuar plotësisht'.

Në përfundim, për të gjitha masat që kanë rezultuar me statusin "pa zbatuar" dhe "zbatuar pjesërisht", nga KLSH është rikërkuar zbatimi i plotë i tyre; ndërsa për masat me status "në proces zbatimi" inkurajohet përshpejtimi i procesit deri në zbatimin e plotë të tyre.

19. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

Nga auditimi i ushtruar në Fondin për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi Auditimin IT' për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe përcjellë në subjekt me shkresën Nr. 288/7 prot, datë 15.09.2023 rezultoi se:

- subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenit 15, shkronja j.
